



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:037317  
Datë: 26.02.2025  
Numri i dokumentit: 06903942

**P.nr.395/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi Mucaj, në çështjen penale kundër të pandehurit B.S, nga për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 181 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.1949/2022 të datës 07.05.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 16.02.2025, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, përfaqësueses të dëmtuarit me autorizim av.Njomza Hoxha nga Peja, të pandehurit B.S, si mbrojtëses së tij av.Valbona Berbati, nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare, me datën 18.02.2025, mori dhe shpalli, ndërsa me datën 26.02.2025, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**B.S**, i lindur me dt. ...., në Deçan, tani me banim në Pejë rr. “.....”, nr...., me vendqëndrim në Zvicër, nga i ati A., dhe e ëma H., e lindur ...., i martuar, baba i .. fëmijëve, ka të kryer fakultetin ....., me profesion ....., i gjendjes së mirë ekonomike, posedon nr. tel ....., i identifikuar me nr. personal ....., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak së:**

*Me datë 31.08.2022, rreth orës 12:00, në fshatin Vitomericë, Komuna e Pejës, seriozisht e kanos më qëllim frikësimi të dëmtuarin M.I në atë mënyrë që i pandehuri duke u paraqit me emër të rrejtshëm si D.M, me pretekst se i dëmtuari në vazhdimësi po e shqetëson bashkë partiaken e të pandehurit D,B, tani ..... përmes telefonit nga nr. ...., e kanos me fjalët “ ska me të vy as*

*shpija as pasuria dhe jetën kam me ta q.. ty dhe D.” me ç ‘rast tek i dëmtuari M.I, shkakton frikë dhe ankth.*

-Me çka ka kryer veprën penale ‘**Kanosje**’ nga neni 181 parag. 2 të KPRK-së,

Andaj, në aplikim të nenit 4, 7, 8, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70 dhe neni 181 par.2 të KPRK-së, si dhe neni 241, 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.2 2.4, par. 6, 364, 365, 449, 450, 458, 459 dhe 462 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim me pëlqimin e tij, e në kuptim të nenit 44 par.1 dhe 2 të KPRK-së, i është **ZËVENDËSUAR ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej dymijë e pesëqind (2500) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk paguan brenda afatit të përcaktuar dënimit e shqiptuar me gjobë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumën prej njëzetë (20) euro për një ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III.** Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në formën e paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej gjashtëdhjetë (60) euro si dhe shumën prej njëzetë (20) euro në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm
- IV.** I dëmtuari M.I, nga fshati ....., ....., i Komunës së Pejës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datën 07.05.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjën PP/II.nr.1949/2022, kundër të pandehur B.S nga Peja, për shkak të veprës penale “Kanosja” nga neni 181 paragrafi.2 të KPRK-së.

Gjykata me datën 16.02.2025, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, kanë qenë prezentë Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, përfaqësuesja e të dëmtuarit av.Njomza Hoxha nga Peja, i pandehuri B.S, i cili është sjell nga ana e policisë sipas urdhër arrestit të datës 22.01.2025, mbrojtëses së tij av.Valbona Berbat, nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar së i ka kuptuar këto të drejta, dëshiron të mbrohet personalisht dhe se është i gatshëm të vazhdohet me seancën.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, gjykata, e ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit apo mospranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar këto të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë. Në këtë rast dhe i pandehuri B.S, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, për veprën penale që i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurori i Shtetit deklaroj se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*, poashtu edhe përfaqësuesja e të dëmtuarit, avokatja Njomza Hoxha deklaroj se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit*.

Mbrojtësja e të pandehurit, av.Valbona Berbati, deklaroi se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bërë në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtëse, pas sqarimit të të gjitha pasojave dhe privilegjeve të pranimit të fajësisë, është në mënyrë vullnetare, pa presion, dhunë ose kërcenim, dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtit ti aprovohet*.

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti informues me nr. të rastiit 2022-DA-1545 i dt. 01.09.2022, Shënim zyrtar nga Rrështeri R.G #1232 i dt. 06.09.2022, Raporti fillestar i incidentit me nr. 2022-DA-1545 të dt.24.08.2022, Raporti i oficerit V.D #10780 i dt. 24.08.2022, Raporti i policit hetues S.H #2746 i dt.29.08.2022, Raporti informues nga polici hetues T.H i dt.24.08.2022, Deklarata e të dëmtuarit-dëshmitar M.I dhënë në polici me dt.24.08.2022, Deklarata e të dyshuarit B.S dhënë në polici me dt.12.09.2022 si dhe ajo e dhënë në këtë prokurori më dt.25.04.2024, Deklarata e dëshmitarit S.K e dhënë në polici me dt.24.08.2022, Deklarata e dëshmitarit O.T e dhënë në polici me dt.24.08.2022, CD komunikimi mes të pandehurit dhe të dëmtuarit si dhe fotografitë të bashkangjitura në shkresa të lëndës. Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me

shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, në fjalën e tij përfundimtare duke u deklaruar për rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që të marr ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndaj të pandehurit ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin fajësisë.*

Përfaqësuesja e të dëmtuarit, av.Njomza Hoxha, deklaroi se: *i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim, të marr parasysht rrethanat rënduese, faktin që i njëjti përveç kanosjes që i ka bërë të dëmtuarit, të cilit i ka shkaktuar frikë dhe panik, mirëpo të njëjtin rast ndaj të njëjtit ka hedhur edhe fyerje dhe akuza të rënda në drejtim të moralit si pasojë e të cilave të njëjtit i ka shkatërruar familjen. Kanosjen nuk e ka bere vetëm njëherë por disa here, ndërsa për kompensimin e dëmit do të paraqesin kërkesën pasurore juridike.*

Mbrojtësja e të pandehurit, av.Valbona Berbati, deklaroi se: *kërkoj nga gjykata që të mirët parasysht pranimi i fajësinë nga ana e të mbrojturit tim, pendimi i sinqerte, kërkim falja ndaj të dëmtuarit, gjykatës, dhe prokurorisë, i cili veprim ka qene i pa menduar mirë, i cili veprim ka qenen i nxitur ose i shtyre në forme të shakasë nga një shok i tij, nuk ka pasur për qëllim ta dëmtoj apo t'ia shkatërroj familjen, gjë e cila nuk është e vërtet, ndërkaq si rrethane lehtësuese i propozoj gjykatës që të mirët paraqitja e tij në Prokurori si dhe të mos mirët si rrethane rënduese urdhër arresti i lëshuar i tij, andaj i propozoj gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të butë i cili dënim të kthehet në dënim me gjobë, për të cilin jep pëlqimin edhe i mbrojturi im, i cili ka mundësia që ta paguaj dënimit e shqiptuar nga ana e gjykatës.*

I pandehuri B.S, deklaroi se: *jam penduar për veprën penale, të dëmtuarin nuk kam pasur mundësi që ta takoj për ti kërkuar falje, mirëpo jam i gatshëm që ti kërkoj falje, pajtohem lidhur me atë që tha mbrojtësja ime, kisha kërkuar që të mirën parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese, një dënim sa më të butë që i njëjti të më kthehen në dënim me gjobë.*

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të “Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv i këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale e të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, keqardhjen e shprehur për veprën e kryer, se i njëjti është në marrëdhënie pune jashtë vendit dhe është mbajtës i vetëm i familjes, ndërkaq si rrethana rënduese në rastin konkret gjykata mori shkallën e lartë të dashjes së të pandehurit në kryerjen e kësaj veprës penale duke u prezantuar ne emër të një personi tjetër, po ashtu gjykata mori për bazë edhe faktin se sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.369/23 i dt.13.02.2023, i cili është bërë i plotfuqishëm me dt.16.10.2023, i pandehuri është dënuar për shkak të veprave penale *“Kanosje” nga neni 181 par.2 të KPRK-së, dhe “Ngacim” nga neni 182 par.1 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit i është shqiptuar dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vite e tre (3) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse në afat prej 3 viteve, nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, i cili dënim me pëlqimin e tij e konform nenit 44 par.1 dhe 2 e lidhur me nenin 181 par.2 të KPRK-së, ia ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën e përcaktuar si në pikën e I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe kjo pasi që i pandehuri dhe mbrojtësja e tij ne seancen e shqyrtimit fillestar kanë dhënë pëlqim për një gjë të tillë.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është e bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon, refuzon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 60,00 euro, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit M.I, nga fshati ....., Komuna e Pejës, në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë konform dispozitës së nenit 462 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.395/24, me datën 26.02.2025.**

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjykuese

\_\_\_\_\_  
**Leonita Lajçi-Muçaj**

\_\_\_\_\_  
**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.